

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

BUXHETI 2025

për

qytetarët

Një vështrim i thjeshtëzuar në
financat publike për vitin **2025**

Ky material mbështetet në Projektligjin për Buxhetin e Vitit 2025 të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.664 datë 24.10.2024. Ky material paraqet një variant të përmbledhur dhe jo shterues të propozimit të buxhetit 2025

Përdorimi i tekstit

Përdorimi i tekstit dhe të dhënave të paraqitura në këtë material, me kusht që të referohen pandryshim, lejohet me citimin e burimit:

Burimi: Ministria e Financave

Modifikimi i tekstit

Në rast se teksti, të dhënat apo grafikët e paraqitur këtu përdoren për të gjeneruar material apo të dhëna të ndryshme, preferohet citimi: Bazohet në të dhëna nga Ministria e Financave.

Informacione të tjera

Projektligji i plotë për Buxhetin 2025 dhe tabelat përkatëse janë botuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave:

www.financa.gov.al

Për informacione apo sqarime të nevojshme mund të drejtoheni në adresën: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Ministria e Financave, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë.

e-mail: budget.programming@financa.gov.al

Botimi i këtij dokumenti u mundësua nga Ministria e Financave

Tetor 2024



20

BUXHETI PËR QYTETARËT

Një vështrim i thjeshtëzuar në financat publike për vitin 2025

25

Përmbajtja

BUXHETI PËR QYTETARËT 2025	4
MESAZH PËR LEXUESIN	5
TË DHËNA DEMOGRAFIKE	7
PUNËSIMI	8
RRITJA EKONOMIKE	9
TË ARDHURAT E BUXHETIT	10
SHPENZIMET E BUXHETIT	11
POLITIKAT PRIORITARE TË QEVERISË DHE FINANCIMI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR REALIZIMIN E TYRE	12
BUJQËSIA DHE ZHVILLIMIT RURAL	13
MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT EKONOMIK	15
INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA	16
SHËNDETËSIA	18
ARSIMI	20
MBROJTJA SOCIALE	21
DREJTËSIA DHE RENDI	22
MBROJTJA	23
ARGËTIMI, KULTURA DHE ÇËSHTJET FETARE	24
MBROJTJA E MJEDISIT	25
STREHIMI	26
DEFICITI BUXHETOR DHE BORXHI PUBLIK	27

Mesazh për lexuesin



Petrit MALAJ
Ministër i Financave

Të nderuar qytetarë të Republikës Shqiptarisë,

Dëshiroj t'ju njoh shkurtimisht dhe në mënyrë të thjeshtuar me propozimin e buxhetit të shtetit për vitin 2025. Ky projektbuxhet siguron mbështetjen e duhur për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit si dhe financon reformat e domosdoshme për përshpejtimin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Në këtë kuadër, projeksionet e projektbuxhetit 2025 bazohen në një rritje ekonomike pozitive prej rreth 3.9% përgjatë periudhës 2025-2027, duke vijuar politikën e konsolidimit fiskal. Deficiti buxhetor planifikohet në 2.6% të PBB duke mundësuar një borxh publik më të ulët që pritet të shkojë në 55.8% të PBB në fund të vitit 2025.

Projektbuxheti financon me prioritet sektorë të rëndësishëm si arsimi, bujqësia, shëndetësia, mbrojtja sociale, infrastruktura rrugore dhe digjitale, si dhe mbështet realizimin e një vëllimi të konsiderueshëm investimesh publike me mbi 6.2% të PBB duke ofruar kështu mjetet financiare të duhura për avancimin apo përfundimin e projekteve strategjike të konektivitetit rrugor, hekurudhor dhe portual, si dhe të projekteve të investimeve në sektorët e tjerë prioritarë.

Për vitin 2025, të ardhurat totale buxhetore parashikohen të arrijnë në 754.6 miliardë lekë, me një rritje prej 5.6% krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2024. Bazuar në projeksionet e të ardhurave të vitit 2025, totali i të ardhurave të buxhetit shkon në 28.8% e PBB-së nga 27.5%, që kanë rezultuar mesatarisht në tre vitet paraardhëse, pra me një rritje mesatare prej 1.3% të PBB-së. Kjo rritje bazohet kryesisht në përmirësimin e politikave tatimore dhe administrimit fiskal, duke zgjeruar bazën e tatimit me synim minimizimin e informalitetit dhe shmangies tatimore në ekonominë e vendit.

Në krahun e shpenzimeve buxhetore, në projektbuxhetin e vitit 2025, janë parashikuar të shpenzohen 822.7 miliardë lekë ose 31.4% e PBB, me një rritje në vlerë absolute prej 51.3 miliardë lekë krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2024. Një vëmendje e veçantë në këtë projektbuxhet do t'i kushtohet dhe financimit të masave që do të ndërmerren nga qeveria në kuadër të Planit të Rritjes me Bashkimin Europian (EU Growth Plan), si dhe disbursimeve të pritshme të financimeve nga BE-ja për këtë qëllim. Për vitin 2025, parashikohen të financohen rreth 5.7 miliardë lekë të përbëra nga: financime të masave të agjendës së reformave që do të ndërmerren nga qeveria në kuadër të këtij Plani (1.2 miliardë lekë) dhe disbursime të pritshme nga BE-ja (grante + kredi) në masën 4.5 miliardë lekë.

Në projektbuxhetin e vitit 2025 do të vijojë adresimi i çështjeve të lidhura me barazinë gjinore, kryesisht në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe rendit publik. Në këtë projektbuxhet parashikohet që rreth 9.1% e shpenzimeve të përgjithshme publike t'i dedikohen politikave publike me bazë gjinore, që synojnë të shenjestrojnë dhe për pasojë të zvogëlojnë hendeqet gjinore.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2025, janë parashikuar në masën 89.9 miliardë lekë, me një rritje prej 13.2% më shumë se buxheti i vitit 2024. Këto shpenzime për vitin 2025, zënë 3.43% të PBB-së nga 2.9 që zinin në vitin 2024 ose nga 2.3% në vitin 2015. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024 është 1.8 miliardë lekë më shumë ose rreth 7.6% më e lartë, dhe krahasuar me vitin 2015 (viti para zbatimit të reformës administrativo-territoriale), është 13.9 miliardë lekë më shumë ose mbi dy herë më e lartë.

Projektbuxheti 2025 do të vijojë të mbështesë mbulimin universal shëndetësor, shërbimin arsimor cilësor, shërbime publike të dixhitalizuara, mbështetje sociale për shtresat në nevojë dhe siguri kombëtare për të gjithë qytetarët e vendit tonë!

Faleminderit




TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Sipas të dhënave të INSTAT, Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023 rezultoi 2.4 milionë banorë, me rënie prej 420 mijë persona, krahasuar me Censin e 2011, që jetojnë brenda kufijve të Shqipërisë, nga të cilët:

2.4

Milionë




1,211,665 gra dhe vajza

50.4%

Rreth 18.4% e popullsisë përbëhet nga gra/vajza dhe burra/djem të moshës 20-34 vjeç, prej të cilëve/cilave 49.7% janë gra dhe vajza (16.1% e të cilave janë të moshës 25-29 vjeç).

1,190,448 burra dhe djem

49.6%



Jetëgjatësia mesatare për vitin 2024 parashikohet të jetë **77.9 vjeç** për burra dhe **81.9 vjeç** për gratë

Tirana vijon të jetë qarku me popullsinë më të lartë në vend me 758,513 banorë, nga të cilët 391,085 gra dhe vajza (ose 51.6%) dhe 367,428 burra dhe djem (ose 48.4%) e ndjekur nga Fieri (240,377 banorë, 50.% gra dhe 50% burra), Elbasan (232,580 banorë, 50% gra dhe 50% burra) dhe Durrës (226,863 banorë, 50% gra dhe 50% burra).

PUNËSIMI

Referuar statistikave të [INSTAT](#) shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 67.2%.

72.9% për burrat
61.8% për gratë

Struktura e të punësuarve sipas statusit të aktivitetit tregon se:

Sipas vlerësimeve të anketës për vitin 2023, rezulton se për grupmoshën 15 vjeç e lart, 49,0 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 29,7 % janë të vetë-punësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 21,3 % janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familje.



Paga mesatare bruto në vitin 2023
70.359
lekë

Shkalla e Punësimit (15-64 Vjeç)
2023

72.9%

Burra

61.8%

Gra

Papunësia

10.7%

Bujqësia
32.3%

Tregti, Transport,
Hoteleri, Shërbime
të biznesit dhe
administrative
29.1%


Administrim publik,
Shërbimet Sociale, dhe
aktivitete e shërbime të tjera
17.6%

Gratë dhe burrat e moshës 15-64 vjeç

RRITJA EKONOMIKE

Rritja ekonomike pritet të jetë rreth 3.9% për vitin 2025, ndikuar nga zhvillimet e ekonomisë së brendshme dhe pritshmëritë për ekonominë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian. Për periudhën afatmesme 2025-2027 rritja parashikohet mesatarisht rreth 3.9% në vit. Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht kërkesa e brendshme, nga rritja e mëtejshme e konsumit privat, ashtu edhe nga investimet në infrastrukturë si dhe zhvillimi i sektorëve strategjikë si turizmi.

Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2025-2027) parashikohet të rritet në terma real me mesatarisht rreth 2.8% në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.3 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real me rreth 5.3% në vitet 2025-2027, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.4 pikë përqindje në vit.




Inflacioni mesatar pritet të qëndrojë stabil në nivelin 3% përgjatë 2025-2027 ndërsa Prodhimi i Brendshëm Bruto për banor (PBB/banor) pritet të rritet nga 1041.6 mijë lekë për banor në vitin 2024 në 1098.3 mijë lekë për banor në vitin 2025.

RRITJA
EKONOMIKE

3.9

TË ARDHURAT E BUXHETIT

Në vitin 2024, të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë 674.7 miliardë lekë (ose 27.7% të PBB), prej të cilave, të ardhurat tatimore zënë 633.74 miliardë lekë (ose 26% të PBB) dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mblidhen nga tatimet dhe doganat janë 447 miliardë lekë (ose 18.4% të PBB). Të ardhurat nga kontributet planifikohen të jenë 157.6 miliardë lekë (ose 6.5% të PBB).



SHPENZIMET E BUXHETIT

6.2% PBB



Investime Publike

754.65
miliardë
lekë

Mbrojtja Sociale - 248.08

Shërbimet e Përgjithshme Publike* - 127.15

Mbrojtja - 42.2

Rendi dhe Siguria Publike - 42.5

Mbrojtja e Mjedisit - 7.04

Çështjet Ekonomike - 119.6

Strehimi - 56.79

Shëndetësia - 76.26

Arsimi - 82.5

Argëtimi, Kultura dhe Çështjet Fetare - 12.2

Fondi rezerve, Kontingjenca e Risqeve të Borxhit dhe Politika e rritjes së Pagave - 5.78




Shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë mbështeten në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2022-2030 duke i kushtuar një vëmendje të veçantë dixhitalizimit, turizmit, sigurisë kombëtare, bujqësisë e zhvillimit rural, integritimit european dhe planit të rritjes së BE. Projektbuxheti 2025 akomodon financimit të masave që do ndërmerren nga shteti ynë në kuadër të Planit të Rritjes me Bashkimin European (EU Growth Plan) si dhe disbursimeve të pritshme të financimeve nga BE për këtë qëllim.

Shpenzimet e personelit për vitin 2025, reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike, si dhe koston e plotë të politikës së rritjes së pagave (+40 miliardë lekë) të nisur në prill të vitit 2023 dhe të finalizuar në korrik të vitit 2024. Shpenzimet totale për pagat në Administratën Publike në nivel qendror për 86,038 punonjës planifikohen në masën 127.6 miliardë lekë ose 4.9% e PBB.

*Në shpenzimet e këtij funksioni që zënë rreth 4.9% të PBB, përfshihen kostot e funksionimit të administratës qendrore dhe vendore, shpenzimet e interesave, fondi i veçantë i pagave dhe shpenzimet e të ardhurave të tjera jashtë limitit

POLITIKAT PRIORITARE DHE FINANCIMI PËR REALIZIMIN E TYRE

Shtyllat kryesore për përmirësimin e jetesës së grave dhe burrave të të gjitha grupeve sociale në Shqipëri do të jenë: mbrojtja sociale, arsimi, shëndetësia, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional të të rinjve dhe të rejave, mbështetja proaktive ndaj biznesit, sidomos atij rural dhe turizmit.



BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është planifikuar në masën **14.6 miliardë lekë**

1. Prioritetet e sektorit të bujqësisë

- Konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, administrimi i qëndrueshëm, ruajtja e saj nga dëmtimi, gërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë.
- Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët.
- Mbështetje për agroindustrinë.

- Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas.



- Nxitja e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur kooperimin.
- Administrimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet kujdesit, sigurimit dhe administrimit të qëndrueshëm të sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmytjeve.
- Mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

- Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimi i përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit si dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.



ZHVILLIMI RURAL



Sa i përket politikave të zhvillimit rural, prioritet do të kenë edhe:

- Rritja e numrit të grave që përfitojnë shërbimet e këshillimit dhe informacionit bujqësor- ku 520 gra do të përfitojnë shërbime të targetuara informacioni dhe këshillimi bujqësor me një fond prej 2,400,000 lekësh.
 - Shtimi i numrit të përfituesve nga masat mbështetëse në bujqësi në 13 900 përfitues përgjatë 2025-2027, si dhe rritja e numrit të përfituesve nga Skema e Subvencionit të naftës për bujqësinë nga 31 500 përfitues në vitin 2024 në 33 000 përfitues në vitin 2027.
 - Aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agro-përpunim.
-
- Rritja e volumit të eksportit të produkteve bujqësore dhe të agro-përpunimit nga 55.8 miliardë lekë në vitin 2025 në 59.7 miliardë lekë në vitin 2027.
 - Rritja e përqindja e sipërfaqes ujitëse ku fermerët kanë akses në ujë për ujitje, kundrejt sipërfaqes potencialisht të ujitshme (360 000 ha).
 - Numri i të punësuarve në bujqësi dhe agro-përpunim (nga 459 068 të punësuar të parashikuar në vitin 2024 në 495 073 të punësuar në vitin 2027).



MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Prioritetet sa i përket mbështetjes së zhvillimit ekonomik do të jenë:



- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjeve në panairë ndërkombëtare dhe "road show" promovuese, vizita në kompani (after care), në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (BIDS) 2021-2027.
- Ndërmarrja me sukses e aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe të produkteve "Made in Albania".



- Marrja e masave për të rritur konkurrueshmërinë e mikro-ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nëpërmjet aksesit në financë përmes Fondit të Zhvillimit për ndërmarrjet, të parashikuar në ligjin nr. 43/2022 "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme".
- Nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve arsimore dhe bizneseve, përmes aksesit të lehtë të informacionit.
- Zhvillimi i një qasje gjithëpërfshirëse në mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në integrimin e zinxhirit të vlerave globale përmes pjesëmarrjes së Shqipërisë në Programin Evropian të Tregut të Përbashkët 2021-2027, në shtyllën e NVM-ve.

INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

Buxheti në dispozicion për prioritetet në këtë fushë është rreth 74 miliardë lekë.

2.8% e PBB

- Rritja e numrit të përfituesve direkt dhe indirekt si përdorues të rrjetit rrugor, nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Zgjerimi i aksesit si dhe rritja e cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes investimeve publike; dhe përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionare të ujësjellës kanalizimeve, duke standardizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- Rritja e eficiencës së energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme.

Në programin e rrugëve kombëtare do të financohen me prioritet:

- Mirëmbajtja sipas standardeve të 3,532 km rrugë në territorin e Republikës së Shqipërisë, me fond total për shpenzimet e mirëmbajtjes prej 3 miliardë lekë.
- Financimi i rrugës “Elbasan-Lekaj” si dhe “Zgjerimi i Autostradës Tiranë – Durrës”.
- Vijimi i zbatimit të projekteve prioritare si:
 - Ndërtimi i Rrugës së Arbrit;
 - Ndërtimi i Rrugës Milot – Morinë;
 - Ndërtimi i Rrugës Orikum – Dukat, By Pass-Porti i Jahteve.





Shërbimet për ujësjellës - kanalizime do të vijojnë të financohet për të përmirësuar treguesit, si më poshtë:

- Furnizimin me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 22 orë në ditë në vitin 2027;
- Rritjen e numrit mesatar të orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar në 20 orë në ditë deri në 2027, nga 18 orë në ditë në vitin 2025;
- Shtimin dhe përmirësimin e aksesit të qytetarëve në shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm në zonat urbane me 96% dhe në zonat rurale me 70% deri në vitin 2027.

Politikat e zhvillimit të energjisë së rinovueshme do të synojnë të rrisin:

- Përdorimin e Energjive të Rinovueshme nga 39% në vitin 2025 në 46% në vitin 2027;
- Eficiencën e energjisë nga 7.5% në vitin 2025 në 7.9% në vitin 2025;
- Prodhimit vendas së energjisë elektrike në 80.4% në vitin 2027;
- Përdorimin e biokarburanteve në sektorin e transportit nga 1% në vitin 2025 në 3% në vitin 2027;

Planifikimi urban do të synojë më shumë lëvizshmëri dhe infrastrukturë të sigurt, përmes:

- Zhvillimit të qëndrueshëm dhe të balancuar të territorit, duke zbutur pabarazinë rajonale;
- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Terminali i Pasagjerëve Tiranë;
- Ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranë - Rinas dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Vorë - Hani i Hotit .



SHËNDETËSIA

**Politikat
prioritare të
zhvillimit të
shëndetësisë
do të
financohen me
rreth 80.73
miliardë lekë.**

- Financimi i shërbimeve shëndetësore (parësore e spitalore).



**2.9% e
PBB**

- Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i situatës financiare të institucioneve shëndetësore e të mbrojtjes sociale, nëpërmjet përdorimit më efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve.
- Rritja e kosto-efektivitetit të listës së barnave e pajisjeve të rimbursueshme, ku do të mbështeten 400 mijë qytetarë me barna të rimbursueshme në përgjigje të trajtimit të sëmundjeve kronike dhe post- Covid;
- Financimi i paketave të miratuara të shërbimit spitalor në spitalet publike e jopublike për të gjitha gratë dhe burrat e grupeve të ndryshme sociale;
- Pagesa për kujdesin shëndetësor për të gjitha gratë dhe burrat e grupeve të ndryshme sociale, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;
- Kostoja e shërbimeve të reja shëndetësore, me synim ndryshimin e mënyrës së financimit të shërbimeve shëndetësore;
- Financimi i shërbimit të kontrollit bazë mjekësor duke përfutuar falas analiza dhe kontrole periodike për 475 mijë qytetar në vit, gra dhe burra të grupeve të ndryshme sociale të moshës 35-70 vjeç.

Politikat shëndetësore do të vijojnë të mbështesin nënat e reja me shërbime të shëndetit parësor dhe dytësor, ku rëndësi të veçantë zënë investimet në maternitetet e reja me rreth 643 milionë lekë. Për vitin 2025, parashikohet të fillojë rikonstruksioni i Maternitetit Shkodër dhe Fier.

- Për vitin 2025 synohet të rritet numri i Grave dhe vajzave që përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të gjirit me anë të mamografisë së lëvizshme nga 5 450 gra në 5 550 me një kosto prej 10,000,000 lekë, me synim parandalimin e rasteve duke rritur depistimin për kancerin e gjirit kundrejt totalit të grave (grup moshë 50-60 vjeç) nga 20.3% në vitin 2024 në 30% në vitin 2027.

- Për vitin 2025 synohet të rritet numri i Grave dhe vajzave që përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të qafës së mitrës nga 11 000 gra në vitin 2024 në 13 000, me një kosto prej 28,500,000 lekë me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës nga 2.5/100 000 në vitin 2024 në 2/100 000 në vitin 2027.

- Do të intensifikohet puna me mjekët e familjes që të rritet ndërgjegjësimi për kontrollin periodik dhe njëkohësisht do të synohet të rritet numri i burrave të moshës 35-70 vjeç që përdorin shërbimet e check-up për identifikimin në kohë të sëmundjeve, etj.



ARSIMI

3.3% e PBB

Fondet për sektorin e Arsimit në vitin 2025, parashikohet të arrijnë në 85.2 miliardë lekë.


Politikat kryesore për zhvillimin e arsimit gjatë këtij viti synojnë:

- Ofrimin e teksteve shkollore falas për 240 mijë nxënës që ndjekin arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë, si dhe ofrimi i bursave financiare apo kuotë ushqimore/financiare për 4000 nxënës me nevoja të veçanta; Tekstet shkollore falas për arsimin e mesëm ku do të përfitojnë dhe vajzat që vijnë nga familje në nevojë dhe/apo viktima të trafikimit;
- Sigurimin e shërbimit të transportit për 33 mijë vajza dhe djem (44% e të cilëve janë vajza) që kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km nga shkolla, si dhe për rreth 12 mijë mësues/e që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë;
- Mbështetjen financiare për 25 federata sportive nga 48 federata gjithsej në vit;
- Rritjen e numrit të sportistëve të licencuar në federata shqiptare të sportit, në 30,000 deri në vitin 2027, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.

Punësimi dhe aftësimi profesional

Politikat e punësimit dhe të arsimit profesional për gratë dhe vajzat vijojnë të jenë prioritet, ashtu sikurse edhe politikat e mbrojtjes sociale të strehimit social apo të sigurimeve shoqërore, të cilat synojnë jo vetëm fuqizimin, por edhe ndihmën specifike ndaj atyre që janë viktima të dhunës më baza gjinore apo në familje.

- Punësimi nga programet e nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave në 1363 nga 1770 gjithsej me një kosto prej 385,000,000 lekë;
- 150 të rinj vajza e djem përfitues të nismës Garancia Rinore me një kosto prej 200,000,000 lekësh.
- 7500 të trajnuar në Qendrat e Formimit Profesional Publik me një kosto prej 338,972,000 lekësh.



MBROJTJA SOCIALE

Projektbuxheti 2025 garanton rritjen e qëndrueshme të mburojës sociale për shtresat në nevojë, me fokus fëmijët, nënat më shumë fëmijë, të moshuarit dhe familjet.

Do të rritet financimi i politikës së rishikimit të masës së përfitimit për Ndhimën Ekonomike, si dhe politika e mbështetjes për çmimin e energjisë për përfituesit e kategorisë së PAK (Pagesa e Aftësisë së Kufizuar), ku rreth 44% të përfituesve janë gra.

Do të vijojmë përpjekjet për të njohur punën e papaguar të grave dhe vajzave në familje duke mundësuar përfitime monetare për disa grupe të rëndësishme sociale.



- Buxheti për programet e mbrojtjes sociale garanton mbështetjen e mbi 62 mijë familjeve, pjesë e programit të ndihmës ekonomike, ku rreth 47% të përfituesve janë gra të dhunuara.
- Mbështetje për programin e pagesave për mbi 164 mijë përfitues me aftësi të kufizuar dhe kujdestarët e tyre.
- Mbështetje për skemën e pensioneve dhe skemat e tjera të mbështetjes për 780 mijë përfitues për vitin 2025, me një fond total prej 192.3 miliardë lekë.*
- Mbështetje me pension familjar për 47 470 gra me një kosto prej 9.9 miliardë lekë, (kontribues+ transferta nga buxheti).
- Pagesa për barrë lindje për 13 655 nëna ose baballarë me një vlerë 5.6 miliardë lekë.
- Vijon financimi i politikës së mbështetjes së veçantë për gratë e papuna me 3 apo më shumë fëmijë deri 18 vjeç, me të ardhura familjare deri në 100 mijë lekë në muaj, duke i mbështetur me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri 5 vjeç. Për vitin 2025 parashikohet të përfitojnë 8 000 gra me një kosto prej 820,000,000 lekësh.
- Vijon financimi i Programit të "Bonusit të Bebes" për çdo të porsalindur, duke garantuar shpërblimin financiar nga 40,000-120,000 lekë për mbi 33 mijë fëmijë/vit, si një mënyrë për të ndihmuar nënat dhe baballarët e rinj, për të përballuar muajt e parë të lindjes së bebes.

*[\(që mbulohen nga të ardhurat e kontribuuesve në skemën e sigurimeve shoqërore që parashikohet mesatarisht mbi 912 mijë kontribues + transferta nga buxheti i shteti\)](#)

DREJTËSIA DHE RENDI

1.6% e PBB

Shpenzimet buxhetore për funksionin e Drejtësisë dhe Rendit Publik parashikohen në masën 42.5 miliardë lekë.

- Sigurimi i kushteve të përshtatshme për rreth 5,500 të dënuar burra, 86 të dënuar gra dhe 36 të dënuar të mitur, si dhe trajtimin me shërbim shëndetësor për 438 të dënuar të sëmurë, me fondin total në rreth 1.95 miliardë lekë.
- Ri-integrimi nëpërmjet zhvillimit të programeve për rehabilitimin në shoqëri të paraburgosurve dhe të dënuarve në përputhje me standardet evropiane, për rreth 360 të dënuar burra, 2 gra dhe 6 të mitur.
- Ofrimi i ndihmës juridike falas për rreth 5,000 individë në total, që plotësojnë kushtet në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas, prej të cilëve 3,000 ose 60% të totalit, gra dhe vajza.
- Realizimi i rreth 18,500 akteve të ekspertimit të klasifikuara si; mjeko-ligjore, toksikologjiko-ligjore, biologjiko-ligjore dhe psikiatriko-ligjore, në përputhje me standardet evropiane.



- Mbikëqyrja në mënyrë efektive e 7000 burrave, 800 grave dhe 200 të miturve gjatë shërbimit të provës.
- Realizimi i skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit nga 1,760 vendime të trajtuara me kompensim kundrejt totalit të vendimeve të Regjistrimit elektronik të ATP-së të parashikuar për vitin 2025, në 2,130 për vitin 2027;
- Garantimi i interesit më të lartë të fëmijëve, nëpërmjet vendosjes në familje të përhershme që përshtaten me nevojat specifike të secilit prej tyre, me synimin që 100% e totalit të birësimeve të rezultojnë të suksesshme
- Rritja e sigurisë publike dhe sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimi i kontrollit të territorit me policimin në komunitet duke synuar shpejtësinë e reagimit të shërbimeve policore në 13 minuta në vitet 2025-2027;
- Reduktimi i kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje 13 minuta në vitin 2027.



MBROJTJA

2.01% e PBB

Buxheti i vitit 2025 i Ministrisë së Mbrojtjes arrin në 52.7 miliardë lekë nëpërmjet të cilit garantohej:

- Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakëve gra dhe burra.
- Aktiviteti i personelit për 755 ushtarakë të forcave ajrore, 1,350 personel i Forcave të Armatosura, ku rreth 15% e tyre janë gra dhe vajza me dhe pa uniform.
- Numri i pacientëve të shtruar të planifikuar dhe urgjente në Spitalin e Traumës parashikohet mesatarisht 75 400 pacientë.
- Aktiviteti i 7,981 punonjësve (personel) të arsimuar sipas kriterëve dhe standardeve të NATO-s ku 860 janë gra në uniformë dhe parashikohet të rekrutohen edhe 67 gra dhe vajza të tjera në FA.
- Trajtim i veçantë për 35 288 ushtarakë në rezerve dhe në lirim;
- Numri i operacioneve të planifikuara dhe urgjence parashikohet mesatarisht 54 mijë operacione në Spitalin e Traumës.
- Modernizimi me armatim të lehtë dhe municione i Forcave të Armatosura



- Zbatimi në mënyrë cilësore i detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, etj. i realizuar nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë

ARGËTIMI, KULTURA DHE ÇËSHTJET FETARE

0.5% e PBB

Shpenzimet për funksionin e argëtimit, kultura dhe çështje fetare parashikohet të arrijnë në 12.1 miliardë lekë, duke synuar financimin e projekteve me rëndësi për ruajtjen e kulturës dhe traditës, bashkëjetesës fetare, zhvillimit të artit dhe shtimin e turizmit kulturor në Shqipëri.

- Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit, duke përfshirë restaurimin e disa linjave muzeale, si edhe përshtatjen me standarde bashkëkohore. Rritja e numrit të objekteve të trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit të restauruara dhe mirëmbajtura nga 155 në vitin 2024 në 156 në vitin 2027;
- Rritja e mbështetjes për aktiviteteve të fushës së trashëgimisë kulturore nga 107 aktivitete përgjatë viteve 2023-2024 në 110 aktivitete në vitet 2025-2027;
- Rritja e numrit të objekteve të regjistruara në databazën kombëtare të trashëgimisë, nga 130 mijë objekte në vitin 2024 dhe 140 mijë në vitet 2025 – 2027;
- Rritja e numrit të projektve me thirrje në mbështetje e industrive krijuese duke respektuar barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, grupet e marginalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi nga 220 në vitin 2024, në 240 në vitin 2025, 260 në vitin 2026 dhe 280 në vitin 2027;
- Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të bukura (Galeria Kombëtare e Arteve);
- Ndërtimi i Godinës së Teatrit Tiranë;
- Zhvillimi i rreth 750 aktiviteteve të kalendareve artistik të programuara nga institucionet qendrore publike të artit dhe kulturës;
- Mbështetja e skenës së pavarur për të mundësuar edukimin përmes kulturës, si dhe përfaqësimi i produktit artistik në arenën elitare ndërkombëtare
- Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave;
- Përfundon financimi i rikonstruksionit të Teatrit "Aleksandër Moisiu", Durrës.






Në sektorin e kulturës do të vijohet t'i jepet përparësi:

- Grave dhe vajzave artiste që promovojnë skenën e pavarur;
- Grave dhe vajzave artizane që ruajnë dhe trashëgojnë më tej vlerat dhe traditat e kulturës shqiptare.

MBROJTJA E MJEDISIT

Duke marrë gjithnjë e më tepër vëmendje e rëndësi në mënyrën se si aktivitetet e ndryshme publike ndikojnë në mjedis, efektet e ndryshimeve klimatike, si dhe krijimin e vendeve të reja të punës apo mundësitë në investime në "ekonominë e gjelbër", ky sektor do të financohet me 7 miliardë lekë ose 0.3% të PBB dhe do të fokusohet ndër të tjera edhe në:

- Diversifikimin e produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjeter, duke promovuar gjerësisht Shqipërinë në komunitetin ndërkombëtar, si një destinacion të denjë për të konkurruar globalisht.
- Ofrimin e incentivave për rritjen e numrit të bizneseve në sektorin e agroturizmit.
- Arritjen e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit.
- Përmirësimin e performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Rritjen e përqindjes së mbetjeve që shkojnë në landfille sanitare kundrejt mbetjeve të hedhura në vend-depozitime të hapura në 69%.
- Rritjen e përqindjes së mbetjeve të ricikluara në 19% në vitin 2027 nga 18% të parashikuar në vitin 2025.
- Nivelin e punësimit në sektorin e turizmit me 8.7% deri në vitin 2027.



STREHIMI



Objektivi i këtij programi është të sigurojë, deri në vitin 2030, strehim të përshtatshëm e të përballeshëm për rreth 35,000 individëve/familjeve që kanë aplikuar për strehim dhe që nuk përballojnë dot kostot e tregut të banesave.

Për vitin 2025 parashikohen 1.29 miliardë lekë të cilat do të financojnë:



- Pagesën e bonusit të qirasë për rreth 1,900 familjet përfitues me një fond prej 200 milionë lekë.
- Skemat e investimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës për gra dhe burra nga grupet sociale, parashikohen mesatarisht 348 familjeve përfituese në nevojë, me një kosto prej 348,000,000 lekë.
- Subvencionim e qirasë për të shpronësuar 367 familje përfituese nga projekti Unaza Madhe Tiranë, me një kosto prej 40 milion lekë.
- Për gratë dhe vajzat e dhunuara, apo familje një prindërore, do të vijohet mbështetja me strehim social. Kostoja për strehimin social të 970 grave dhe vajzave të kategorisë së përcaktuar sipas ligjit do të jetë 64,066,594 lekë, përlllogaritur si përpjesë e dy produkteve kryesore të skemave.

DEFICITI BUXHETOR DHE BORXHI PUBLIK

Deficiti buxhetor për vitin 2025 planifikohet të jetë në nivelin 2.6% të PBB. Balanca primare pritet të jetë e balancuar për vitin 2025.

Balanca e përgjithshme e qeverisë (Deficiti fiskal në % të PBB)						
	2019	2020	2021	2022	2023	2024*
<i>Balanca fiskale, (në % ndaj PBB)</i>						
Shqipëria	-1.9	-6.7	-4.6	-3.7	-1.3	-2.3
Bosnja dhe Hercegovina	1.9	-5.2	-0.3	-0.4	n.a	-1.5
Kosova	-2.9	-7.6	-1.2	-0.5	-0.2	-2.9
Maqedonia	-2.0	-8.0	-5.3	-4.4	-4.9	-3.7
Mal i Zi	-2.0	-11.1	-1.9	-4.2	0.6	-3.7
Serbia	-0.2	-8.0	-4.1	-3.2	-2.2	-2.2
Mesatarja e rajonit	-1.2	-7.8	-2.9	-2.7	n.a	-2.8

Në vitin 2024 parashikohet që borxhi publik bruto të bjerë në rreth 56.3% të PBB-së dhe pritet të vijojë të bjerë më tej në rreth 55.8% në vitin 2025. Sipas skenarit bazë, Borxhi Publik Bruto pritet të bjerë në rreth 55.0% në vitin 2026 dhe më tej në rreth 48.5% në vitin 2031.

Tabela 1: Borxhi publik total (% të PBB)

	2019	2020	2021	2022	2023	2024*
<i>Borxhi publik dhe i garantuar (në % ndaj PBB)</i>						
Shqipëria	65.0	73.9	74.1	64.1	57.5	56.3
Bosnja dhe Hercegovina	32.3	36.1	33.9	29.3	26.9	29.3
Kosova	17.6	22.4	21.5	20.0	17.5	n.a
Maqedonia	40.5	50.8	51.4	50.5	53.1	54.6
Mal i Zi	76.5	105.3	82.5	68.0	59.3	61.7
Serbia	52.0	57.0	56.5	55.2	52.0	51.4
Mesatarja e rajonit	47.4	57.7	53.4	47.9	41.8	n.a

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), Ministria e Financave (2024)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE